



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1528/8 prot.

Datë 17.06.2026

V E N D I M
Nr.819/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.06.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “RSM COMPANY” SHPK, përfaqësuar nga dega e saj në Shqipëri shoqëria “R|S|M Construction” në procedurën e prokurimit “E hapur,” me REF-81377-04-08-2026, me objekt: “Investime për transformimin e aseteve publike me potencial zhvillimi në modele të standardit më të lartë të zhvillimit: “Përforcimi i godinës së shtëpisë së fëmijës “Vangjel Pulla”, Sarandë.” me fond limit 53,867,793.17 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “MANE/S” SHPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “RSM COMPANY” SHPK, përfaqësuar nga dega e saj në Shqipëri shoqëria “R|S|M Construction”, me NIPT L04803001U dhe adresë Njesia Nr.8, Rruga Xhorxhi Martini, Nr. 20, Godine Nr. 11 - kateshe, Shkalla 2, Kati 7, Tiranë

Operatori ekonomik “MANE/S” SHPK, me NIPT J64103865K dhe adresë Lagja 2, P 46,, Sarandë.

Autoriteti Kontraktor:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
Adresa: “Rruga Sami Frashëri nr.10”, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V e r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.5. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 09.04.2026, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur,” me REF-81377-04-08-2026, me objekt: “Investime për transformimin e aseteve publike me potencial zhvillimi në modele të standardit më të lartë të zhvillimit: “Përforcimi i godinës së shtëpisë së fëmijës “Vangjel Pulla”, Sarandë.”, me fond limit 53,867,793.17 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.2. Në datën 27.04.2026 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt- ankimi.

II.3. Në datën 05.05.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

Eurondertimi 2000	46,320,840 lekë	254,25 pikë	Kualifikuar
Lis Konstruksion	39,566,214 lekë	249,45 pikë	Kualifikuar
Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan	41,542,842.09 lekë	247,80 pikë	Kualifikuar
Curri	45,038,909.03 lekë	244,95 pikë	Kualifikuar
2 N	46,970,670 lekë	227,10 pikë	Kualifikuar
Eral Construction Company	46,472,341 lekë	223,20 pikë	Kualifikuar
Desaret Company	50,647,189.24 lekë	204,30 pikë	Kualifikuar
Bahas	34,457,368.68 lekë		Skualifikuar
Rsm Company	38,815,455.09 lekë		Skualifikuar
Mane/S	41,934,369.4 lekë		Skualifikuar

II.4. Në datën 12.05.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim Fituesi Paraprak” për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.5. Në datën 18.05.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6671 dhe nr.1528/2026 prot, datë 18.05.2026 i operatorit ekonomik “Rsm Company” SHPK, përfaqësuar nga dega e saj në Shqipëri shoqëria “R|S|M Construction” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur,” me REF-81377-04-08-2026, me objekt: “Investime për transformimin e aseteve publike me potencial zhvillimi në modele të standardit më të lartë të

zhvillimit: “Përforcimi i godinës së shtëpisë së fëmijës “Vangjel Pulla”, Sarandë.”, me fond limit 53,867,793.17 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Rsm Company” SHPK, përfaqësuar nga dega e saj në Shqipëri shoqëria “R|S|M Construction” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit Nr. 1528/1 prot., datë 19.05.2026.

II.5.2. Me shkresën nr.1528/2 prot., datë 02.06.2026, me objekt “*Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacion KPP-së...*” Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor duke i kërkuar informacion me përmbajtje si vijon: “*..autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “RSM COMPANY” SHPK, përfaqësuar nga dega e saj në Shqipëri shoqëria “R|S|M Construction” SHPK,, si dhe vendimin e autoritetit tuaj kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues*”.

II.5.3. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor me shkresën nr.1888 prot., datë 01.06.2026, me objekt “*Mbi vendimin e KSHA lidhur me ankesën elektronike A/2026/6671....*”, protokolluar me tonën me nr.1528/3 prot., datë 08.06.2026, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin e KSHA datë 01.06.2026, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues. Referuar vendimit të KSHA datë 01.06.2026, rezulton se ky i fundit ka shqyrtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj.

II.5.4. Operatori ekonomik ankimues nëpërmjet shërbimit postar me shkresën nr.50 prot., datë 10.06.2026, me objekt “*Parashtesë shtesë në lidhje me përgjigjen e autoritetit kontraktor...*”, protokolluar me tonën me nr.1528/4 prot., datë 11.06.2026, ka depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumenta shtesë lidhur me vendimin e KSHA-së.

II.5.5. Vendimin e KSHA datë 01.06.2026, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Rsm Company” SHPK autoriteti kontraktor e ka përcjellë pranë KPP edhe me shkresën nr.1888/2 prot., datë 08.06.2026, me objekt “*Kthim përgjigje shkresës nr.1528/2 prot., datë 02.06.2026...*” protokolluar me tonën me nr. 1528/5 prot., datë 15.06.2026.

II.6. Në datën 18.05.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, janë administruar ankimet elektronike me nr.

A/2026/6671 dhe nr.1538/2026 prot, datë 18.05.2026, A/2026/6673 dhe nr.1538/1/2026 prot, datë 18.05.2026, A/2026/6674 dhe nr.1538/2/2026 prot, datë 18.05.2026, A/2026/6675 dhe nr.1538/3/2026 prot, datë 18.05.2026 të operatorit ekonomik “MANE/S” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur,” me REF-81377-04-08-2026, me objekt: “Investime për transformimin e asetëve publike me potencial zhvillimi në modele të standardit më të lartë të zhvillimit: “Përforcimi i godinës së shtëpisë së fëmijës “Vangjel Pulla”, Sarandë.” me fond limit 53,867,793.17 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të vleresimit të ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “MANE/S” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.6.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit Nr. 1538/4 prot., datë 19.05.2026.

II.6.2. Me shkresën nr.1538/6 prot., datë 02.06.2026, me objekt “*Mbi detyrimin e autoriteti kontraktor për dhënie informacion KPP-së...*” Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor duke i kërkuar informacion me përmbajtje si vijon: “*..autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “Mane/S” SHPK,, si dhe vendimin e autoritetit tuaj kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues*”.

II.6.3. Me shkresën nr.1834 prot., datë 26.05.2026, me objekt “*Vënia në dispozicion e ankesës së OE “Mane/S” SHPK...*”, protokolluar me tonën me nr.1538/5 prot., datë 28.05.2026 autoriteti kontraktor i është drejtuar KPP për vënien në dispozicion të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Mane/S” SHPK.

II.6.4. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor me shkresën nr.1889 prot., datë 01.06.2026, me objekt “*Mbi vendimin e KSHA lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Mane/S SHPK....*”, protokolluar me tonën me nr.1538/7 prot., datë 08.06.2026, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin e KSHA datë 01.06.2026, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues.Referuar vendimit të KSHA datë 01.06.2026, rezulton se ky i fundit ka shqyrtuar ankesën e peratorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj.

II.6.5. Vendimin e KSHA datë 01.06.2026, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Mane/S” SHPK autoriteti kontraktor e ka përcjellë pranë KPP edhe me shkresën nr.1889/2 prot., datë 08.06.2026, me objekt “*Kthim përgjigje shkresës nr.1538/6 prot., datë 02.06.2026...*” protokolluar me tonën me nr. 1538/8prot., datë 15.06.2026.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “R|S|M Construction d.sh.h (dega e shoqërisë mëmë RSM COMPANY), mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se: “Operatori ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h L04803001U “RSM COMPANY” sh.p.k (mëma) Nr.Biznesi 810802422, nuk plotëson Kriterin për Kapacitetin Teknik pika 2.3.1 të Kriteve të Veçanta në DST për objektin: “Investime për transformimin e aseteve publike me potencial zhvillimi në modele të standardit më të lartë të zhvillimit: “Përforcimi i godinës së shtëpisë së fëmijës “Vangjel Pulla”, Sarandë”, për sa i përket “Përvojës së suksesshme në realizimin e punëve të ngjashme,...

Konkretisht, operatori ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h L04803001U “RSM COMPANY” sh.p.k (mëma) Nr.Biznesi 810802422, nuk plotëson kriterin e punëve të ngjashme sipas kushtit a) Punë të ngjashme (Elementi Natyrë e Ngjashme) për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (në vlerën 26,933,897 lekë pa TVSH) dhe as kushtin b) Punë të ngjashme (Elementi Natyrë e Ngjashme) deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (në vlerën 107,735,586 lekë pa TVSH). Referuar përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik dhe dokumenteve të tenderit, si dhe konceptit të përgjithshëm të prokurimeve, objektet/kontratat e ngjashme, operatorët ekonomik duhet të përmbushin këto elemente:

Elementi Kohë: Kontratat duhet të jenë përfunduar brenda pesë viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

- Elementi Vlerë: Madhësia e kontratave duhet të përmbushë kërkesën e autoritetit kontraktor, qoftë 50% apo 200% të vlerës së kontratës që prokurohet.

- Elementi Natyrë e Ngjashme: Kontratat duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet. Përmbushja e këtyre kriteve është e domosdoshme për të konsideruar përvojën e një operatori ekonomik si të vlefshme.

Mungesa e përmbushjes së një prej këtyre elementëve (kohë, vlerë, natyrë e ngjashme) e bën të pavlefshme përvojën e paraqitur nga kandidatët ofertues. Operatori ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h L04803001U “RSM COMPANY” sh.p.k (mëma) Nr.Biznesi 810802422, per plotesimin e Kriterit për Kapacitetin Teknik pika 2.3.1 të Kriterëve të Veçanta në DST mbështetet ne kapacitetet e OE “UDHA” shpk, bazuar ne deklaraten e angazhimit date 27.04.2026. Referuar nenit 84 të Ligjit për Prokurimin Publik, si dhe nenit 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të VKM nr. 285/2021, pika 2, përcaktohet se kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;

- t’i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.

- t’i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.

- Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

Në rastin konkret, operatori ekonomik ofertues që është mbështetur në kapacitetet e subjekteve të tjera, nuk provon se përmbush të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti kontraktor për kriterin e Kapacitetit Teknik, pika 2.3.1 e Kriterëve të Veçanta në DST.

Sa më sipër, Operatori ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h L04803001U “RSM COMPANY” sh.p.k (mëma) Nr.Biznesi 810802422, skualifikohet nga kjo procedurë”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7/1 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.1 “Kapaciteti teknik” i dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes
- Fature tatimore të situacionit përfunditar të deklaruar në organet tatimore
- Situacioni përfundimtar
- Akt kolaudimi;

Ndërsa në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor “Preventivi pa cmime”, përcaktohet:

Seriali: 48BF1557-0B53-48B5-AF03-6F7E6C8AE1B7

Projektuesi: INSTITUTI I NDERTIMIT
Objekti: SHËTËPIA E FËMIJËS - VANGJEL PULLA - SARANDË

Datë: 24-03-2026

PREVENTIV PUNIMESH

NR.	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE.	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI PA TVSH	VLEFTA PA TVSH	TVSH
		1. PUNIME SHITESASH 2					
1	2.258	Nenshtrese zhavori	m3	35.1			20%
2	2.586	Shtrese llac-cimento t=8cm	m2	224			20%
		SHUMA 1:					
		2. PUNIME HIDROIZOLIMI DHE ÇATITE					
3	2.196/c	Hidroizolim me dy shtresa astar me baze cemento. Pergatitur nga dy komponente A+B	m2	156			20%
		SHUMA 2:					
		3. TE NDRYSHME, ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA					
4	3.164/1t	F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm	ml	130			20%
		SHUMA 3:					
		4. PRISHJE					
5	2.426/4	Prishje soleta b/a	m3	126.7			20%
6	2.426/9	Prishje suvatim i jashtem	m2	1079			20%
7	2.426/11	Prishje suvatim muri i brendshem	m2	2604			20%
8	2.426/12	Prishje suvatim solete (h<4m)	m2	410			20%
9	2.426/13	Prishje suvatim kolona/trare (h<4m)	m2	197			20%
10	2.426/7	Prishje kollona, trare b/a	m3	31			20%
11	2.426/14	Prishje shtrese h/izolim tarace	m2	668			20%
12	2.426/10	Prishje trotuari ekzistues	m2	195			20%
		SHUMA 4:					
		5. PUNIME BETONI DHE B/A					
13	2.262/4b	Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 25/30	m3	42.2			20%
14	2.117/1b	Kollona b/a monolite C 25/30 h ~ 4m	m3	12.3			20%
15	2.574	Trare e arkitrare b/a C 25/30	m3	75.6			20%
16	2.122/1b	Soleta te plota b/a C 25/30, h~4 m	m3	177.3			20%
17	2.200/1	Termoizolim solete 10-20 cm me polisterol kompakt	m2	610			20%
18	2.130.	Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 16/20	m3	19			20%
19	2.112	Mure buto betoni C 12/15	m3	26.1			20%
		SHUMA 5:					
		6. PUNIME HEKUR BETONI					
20	2.166	F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	ton	52.11			20%
21	2.166/1a	F.V. Hekur betoni periodik Ø > 12 mm	ton	22.51			20%
		SHUMA 6:					
		7. PUNIME DHEU					
22	2.5a	Germim e mbushje dheu me krah kat IV per themele, h=1.5m	m3	240			20%
23	2.37/5b	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km	m3	614			20%
		SHUMA 7:					
		8. PUNIME SHITESASH					
24	3.197/2	Prishje shtresash ekzistuese, t=10cm.	m2	668			20%
		SHUMA 8:					
		9. PUNIME TE NDRYSHME					
25	3.621	Trotuar, me 6 cm beton, me lluster	m2	195			20%
		SHUMA 9:					
		10. PUNIME PERFORCIME - KALLEPE - BETONIME E HEKURI PER TUNELE					
26	3.761/2	Torkretim me llac cemento 1: 2, t = 5 cm	m2	1374			20%
		SHUMA 10:					

11. PUNIME BOJATISJE							
27	2.439	Panele metalike per skele	m2	1100			20%
SHUMA 11:							
12. ANALIZA JASHE LISTE							
28	Analiza - 01	Hapje ne murature guri - (thyerje me matrapik dore dhe kompresor ajri per perforcimin e themlit) dhe Heqje pjese theml guri per mbjelljen e koloncinave(heqje guresh me matrapik dore dhe kompresor ajri sipas fugave dhe pergatitja per perfor. e koloncinave dhe berjen e koloncinave te reja	m3	60.2			20%
29	Analiza - 02	Prerje me disk (betone , mur guri)	ml	300			20%
30	Analiza - 03	Suvatim me llac struktural M-30 para dhe pas vendosjes se FRP pergatitja e siperfaqes per perforcim	m2	287			20%
31	Analiza - 04	Perforcim solete dhe traresh me FRP 1, prajmer bikomponent me baze rezine dhe stuko epokside (siperfaqja solete)	m2	144			20%
32	Analiza - 05	Perforcim traresh me kemishe celiku S275 (L75x5 perfshire pllakat dhe prixonierat M16, C15.8)	ml	157			20%
33	Analiza - 06	Mbjellje fitilash me rezine epoksidike (ne betone)	copë	2176			20%
34	Analiza - 07	Boje kundra ndryshkut siperfaqe metalik (lyerja e hekurit me material kunder korrodimit)	m2	50			20%
35	Analiza - 08	Mbjellje fitilash (L=40+30cm)me mbushje llac cimento M10 (ne murature guri)	copë	1000			20%
36	Analiza - 09	Mbjellje fitilash D10/50cm (L=10+5cm) me mbushje llac cimento M10 (ne murature guri)	copë	4612			20%
37	Analiza - 10	Mbjellje fitilash D8/50cm (l=5+5cm) me mbushje llac cimento M30 (ne solete ekzistuese)	copë	1516			20%
38	Analiza - 11	Injektim llaci strukturor (pas pastrimit te muratures se gurit ne fasade ne fugaturat e thella te murit)	m2	156.2			20%
SHUMA 12:							
Shuma Analiza							
SIGURIA NE KANTIER (Plani i Sigurise së Koordinimit në Kantier PSK, Menaxhimi i trafikut dhe kontrolli), min 3%, sipas vendimit nr.216, datë 13.04.2023							
Shuma ANALIZA +PSK							
Fondi Rezervë (3.0%)							
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (3.0%)							
Shuma TVSH (20%)							
Shuma me TVSH							
Totali							

III.1.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “R|S|M Construction d.sh.h (dega e shoqërisë mëmë RSM COMPANY) , ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

1. Formular përmbledhës i vetëdeklarimit i operatorit ekonomik “R|S|M Construction d.sh.h (dega e shoqërisë mëmë RSM COMPANY) , ku në pikën B. Deklaratë Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet e të cilëve do të mbështetet Operatori Ekonomik ka deklaruar si subjekt mbështetës operatorin ekonomik “Udha” SHPK për procedurën konkrete të prokurimit, dhe kapaciteti mbi të cilin do të mbështetet operatori ekonomik ankimues është “Kapaciteti teknik”: 1.Punë e ngjashme, 2. Licence Zbatimi NS-9A.
2. Formular vlerësimi
 - Kontratë me nr. 1000 prot., datë 04.12.2023 me objekt “Rehabilitim i godinës së palestrës në Krutje”, lidhur midis operatorit ekonomik “RSM Company” SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Lushnje, me vlerë xxx lekë me tvsh.
 - Situacion përfundimtar.
 - Akt kolaudimi me datë 26.07.2024
 - Faturë tatimore nr.1, datë 08.01.2024, me vlerë xxx lekë me tvsh.
 - Faturë tatimore nr.47, datë 02.09.2024, me vlerë xxx lekë me tvsh
 - Faturë tatimore nr.18, datë 12.04.2024, me vlerë xxx lekë me tvsh
3. Formular vlerësimi

- Kontratë me nr. 7534/21 prot., datë 14.06.2021 me objekt “*Rikonstruksion i mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesat pallat, të prekura nga tërmeti I datë 26.11.2019, në territorin e Bashkisë lezhë*”, lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomikë “RSM& Hidro Company” SHPK & “Desaret Company” SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Lezhë, me vlerë xxx lekë pa tvsh.
- Situacion përfundimtar.
- Akt kolaudimi me datë 26.04.2022
- Kontratë Bashkëpunimi e lidhur më datë 20.04.2021, midis operatorit ekonomik “RSM Company” SHPK dhe operatorit ekonomik “Desaret Company” SHPK., ku në nenin **“Pjesëmarrja e anëtarëve të grupit”** është përcaktuar: *Shoqëria RSM Company” shpk do të merret me përfundimin e punimeve në fushën e ndërtimit, punimet elektrike si dhe ato në fushën e mjedisit. Shoqëria “Desaret Company” shpk do të mbulojë punët në fushën elektronike dhe ato hidroteknike., shoqëruar me preventivat e punimeve të ndara për secilin operator ekonomik pjesë e BOE, ku vlera e punimeve të marra përsipër nga operatori ekonomik RSM Company është në vlerën xxx lekë pa tvsh, ndërsa vlera e punimeve që do të kryhen nga operatori ekonomik “desaret Company” është në vlerën xxx lekë pa tvsh.*
- Faturë tatimore nr.4, datë 23.08.2021, me vlerë xxx lekë pa tvsh.
- Faturë tatimore nr.5, datë 08.09.2021, me vlerë xxx lekë pa tvsh
- Faturë tatimore nr.6, datë 08.10.2021, me vlerë xxx lekë pa tvsh
- Faturë tatimore nr.7, datë 05.11.2021, me vlerë xxx lekë pa tvsh
- Faturë tatimore nr.2, datë 26.01.2022, me vlerë xxx lekë pa tvsh
- Faturë tatimore nr.14, datë 10.02.2022, me vlerë xxx lekë pa tvsh
- Faturë tatimore nr.29, datë 09.06.2022, me vlerë xxx lekë pa tvsh

4. Formular vlerësimi

- Kontratë me nr. 9348/4 prot., datë 05.03.2021 me objekt “*Hartimi I projektit dhe zbatimit I punimeve për ndërtimin e godinës7 (Seksioni A) në zonën zhvillimore “Kombinat”, lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomikë “Udha” SHPK & “Ndregjoni” SHPK & “Kthella” SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Tiranë, me vlerë xxx lekë me tvsh, ku ndarja e punimeve është përcaktuar: 35% shoqëria ‘Udha’ SHPK, 39% shoqëria ‘Ndregjoni’ SHPK dhe 26 % shoqëria ‘Kthella’ SHPK.*
- Situacion përfundimtar.
- Akt kolaudimi me datë 27.11.2025
- Faturë tatimore nr.90, datë 22.12.2022, me vlerë xxx lekë pa tvsh.
- Faturë tatimore nr.105, datë 06.11.2023, me vlerë xxx lekë pa tvsh.
- Faturë tatimore nr.105, datë 06.11.2023, me vlerë xxx lekë pa tvsh.
- Faturë tatimore nr.87, datë 09.10.2024, me vlerë xxx lekë pa tvsh.
- Faturë tatimore nr.108, datë 18.12.2024, me vlerë xxx lekë pa tvsh.
- Faturë tatimore nr.68, datë 05.12.2025, me vlerë xxx lekë pa tvsh.
- Kontratë Bashkëpunimi e lidhur më datë 11.10.2020, midis operatorit ekonomik “Udha” SHPK, “ndregjoni” SHPK dhe operatorit ekonomik “Kthella” SHPK., ku në nenin **“Pjesëmarrja e anëtarëve të grupit”** është përcaktuar: *Shoqëria RSM Company” shpk do të merret me përfundimin e punimeve në fushën e ndërtimit, punimet elektrike si dhe ato në*

fushën e mjedisit. Shoqëria “Desaret Company” shpk do të mbulojë punët në fushën elektronike dhe ato hidroteknike., shoqëruar me preventivat e punimeve të ndara për secilin operator ekonomik pjesë e BOE, ku vlera e punimeve të marra përsipër nga operatori ekonomik RSM Company është në vlerën xxx lekë pa tvsh, ndërsa vlera e punimeve që do të kryhen nga operatori ekonomik “desaret Company” është në vlerën xxx lekë pa tvah.

III.1.3. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet:

1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.

2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.

3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij.

Autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.

5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes.

6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm.

7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.1.4. Në nenin 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se:

“5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”

Në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.

2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;

- t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.

- t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.

- Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

3. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër.

4. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e kontratës.

5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm.

6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.

7. Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit. Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi.”

III.1.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij nga procedura e prokurimit objekt ankimi nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit KPP vëren, se autoriteti kontraktor në kapacitetin teknik ka kërkuar që “2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme: a) punë të ngjashme **për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme. [...]”**

Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ankimues, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar dokumentacionin e përmendur në pikën III.1.2. të këtij vendimi. Duke marrë shkas nga pretendimet e ankimuesit dhe referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se ankimuesi ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si subjekt mbi të cilin do të mbështetet sa i takon pikës 2.3.1 (punë e ngjashme) të kapacitetit teknik, operatorin ekonomik “Udha SHPK shoqëruar me formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe deklaratën e angazhimit të këtij të fundit, i cili angazhohet posaçërisht për të mbështetur operatorin ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h” me Kapacitetin teknik, 1.Punë e ngjashme 2. Licence zbatimi pika NS-9A. Në rregullat e prokurimit publik konkretisht në pikën 2 të nenit 90 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, është përcaktuar qartë se: “2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;” Akoma më tej në pikën 4 të nenit 90 të aktit nënligjor të sipërpermendur është përcaktuar që: “4. Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor”.

Në rastin konkret, duke gjykuar se operatori ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit konkretisht në seksionin përkatës në pikën B, “Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik” si subjekt mbështetës operatorin ekonomik “Udha” SHPK, lidhur me plotësimin e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapacitetit profesional të operatorëve ekonomikë, KPP gjykon t’i drejtohet urdhërimeve të pikës 4 të nenit 90 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar . Referuar parashikimeve më sipër duhet që operatori ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION”, si operator ekonomik që mbështetet në kapacitetin e subjekteve të tjera, të plotësojë 50% të kërkesës së përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik, ndërkohë ankimuesi, rezulton të jetë mbështetur plotësisht te subjekti mbështetës “Udha” SHPK, i deklaruar si subjekt mbështetës në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, çfarë bie ndesh edhe me parashikimet e dispozitës më sipër. Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, përcaktohen kapacitetet mbi të cilat mund të mbështetesh tek një operator ekonomik konkretisht parashikohet se: “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në

dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Komisioni gjykon se duke e konsideruar mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera kur kjo gjykohet e nevojshme nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi si një kusht të rëndësishëm për plotësimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale, si dhe për vetë ecurinë e kontratës, në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik është përcaktuar që jo vetëm duhet të deklarohet në dokumentet e ofertës mbështetja në kapacitet e subjekteve të tjera, por janë përcaktuar edhe kriteret për këtë mbështetje, njëri prej të cilëve është që në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor, dispozitë e cila në rastin konkret me dokumentacionin e paraqitur nuk plotësohet nga ankimuesi, pasi ai është mbështetur plotësisht te operatori ekonomik “Udha” SHPK lidhur me Kapacitetin teknik pikën 2.3.1 e DT, punët e ngjashme., sikurse provohet nga deklarimi i bërë në formularin përmbledhës të vetdeklarimit. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. KPP thekson, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor sa i takon kriterit 2.3.1 të dokumentave të tenderit dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “Mane/S” SHPK, KPP gjen me vend të sqarojë pozitën e ankimuesit lidhur me pagesën e tarifës financiare për procedurën e prokurimit objekt ankimi. KPP bën me dije se ankimuesi ka aplikuar në sistemin e ankesave elektronike katër herë për të njëjtën procedurë prokurimi, konkretisht përmes ankesave me nr. A/2026/6671 dhe nr.1538/2026 prot, datë 18.05.2026, A/2026/6673 dhe nr.1538/1/2026 prot, datë 18.05.2026, A/2026/6674 dhe nr.1538/2/2026 prot, datë 18.05.2026, A/2026/6675 dhe

nr.1538/3/2026 prot, datë 18.05.2026 në procedurën e prokurimit “E hapur,” me REF-81377-04-08-2026, me objekt: “Investime për transformimin e aseteve publike me potencial zhvillimi në modele të standardit më të lartë të zhvillimit: “Përforcimi i godinës së shtëpisë së fëmijës “Vangjel Pulla”, Sarandë.”, me fond limit 53,867,793.17 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Operatori ekonomik ka ngarkuar mandat pagesë te ankesa me nr. ankimi elektronik A/2026/6674 dhe nr.1538/2/2026 prot, datë 18.05.2026, ndërsa ankesat me numër ankimi elektronik A/2026/6671 dhe nr.1538/2026 prot, datë 18.05.2026, A/2026/6673 dhe nr.1538/1/2026 prot, datë 18.05.2026, A/2026/6675 dhe nr.1538/3/2026 prot, datë 18.05.2026 rezultojnë pa mandat pagesë dhe si rrjedhojë statusi i tyre është “*paparaqitur mandat pagesë*”, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim nga KPP për mosplotësim të kushteve formale sipas legjislacionit për prokurimin publik në fuqi.

III.2.1.Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Mane/S” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se: [...] Konkretisht, operatori ekonomik “MANE/S” sh.p.k, nuk plotëson kriterin e punëve të ngjashme sipas kushtit a) Punë të ngjashme (Elementi Natyrë e Ngjashme) për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (në vlerën 26,933,897 lekë pa TVSH) dhe as kushtin b) Punë të ngjashme (Elementi Natyrë e Ngjashme) deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (në vlerën 107,735,586 lekë pa TVSH). Referuar përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik dhe dokumenteve të tenderit, si dhe konceptit të përgjithshëm të prokurimeve, objektet/kontratat e ngjashme, operatorët ekonomik duhet të përmbushin këto elemente:

Elementi Kohë: Kontratat duhet të jenë përfunduar brenda pesë viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

- *Elementi Vlerë: Madhësia e kontratave duhet të përmbushë kërkesën e autoritetit kontraktor, qoftë 50% apo 200% të vlerës së kontratës që prokurohet.*

- *Elementi Natyrë e Ngjashme: Kontratat duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet. Përmbushja e këtyre kriterëve është e domosdoshme për të konsideruar përvojën e një operatori ekonomik si të vlefshme.*

Mungesa e përmbushjes së një prej këtyre elementëve (kohë, vlerë, natyrë e ngjashme) e bën të pavlefshme përvojën e paraqitur nga kandidatët ofertues.

Sa më sipër, Operatori ekonomik “MANE/S” sh.p.k, skualifikohet nga kjo procedurë.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik Mane/S , për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

1. Formular vlerësimi - data e fillimit të kontratës 02.06.2025 - data e mbarimit të kontratës 25.08.2025 Objekti: " *Investime në infrastrukturën arsimore në kopshte dhe shkolla* ", autoriteti/enti kontraktor/investitori: Bashkia Sarandë. Operator ekonomik: Mane/S shpk. Vlera sipas kontratës: xxxx lekë. Vlera e realizuar: xxx lekë.

- Kontratë me nr. 33 prot., datë 06.03.2025 me objekt “Investime në infrastrukturën arsimore në kopshte dhe shkolla”, lidhur midis operatorit ekonomik “Mane/S” SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Sarandë, me vlerë xxx lekë me tvsh.
- Situacion përfundimtar.
- Akt kolaudimi
- Faturë tatimore nr.8, datë 27.08.2025, me vlerë xxx lekë me tvsh.

III.2.3. Në nenin Neni 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.2.4. Në nenin 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se:

“5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”

III.2.5. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit KPP vëren, se autoriteti kontraktor në kapacitetin teknik ka kërkuar shprehimisht që: **2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:** a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. [...]

III.2.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.7. Nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues: Konkretisht, operatori ekonomik “MANE/S” sh.p.k, nuk plotëson kriterin e punëve të ngjashme sipas kushtit a) Punë të ngjashme (**Elementi Natyrë e Ngjashme**) për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (në vlerën 26,933,897 lekë pa TVSH) dhe as kushtin b) Punë të ngjashme (**Elementi Natyrë e Ngjashme**) deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (në vlerën 107,735,586 lekë pa TVSH), Komisioni konstaton, se arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues lidhet me ngjashmërinë e objektit të punimeve të kontratave të realizuara nga operatori ekonomik “Mane/s” SHPK dhe jo me vlerën apo afatin e realizimit të tyre. Konkretisht, nisur nga arsyeja e skualifikimit, si dhe referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, si dhe preventivit të punimeve të ngarkuar në SPE Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar punimet që do të

realizohen për Përforcimin e godinës së shtëpisë së fëmijës “Vangjel Pulla” ku përfshihen punime si vijon: *punime shtresash, punime hidroizolimi dhe catitë, punime betonu dhe B/A, Punime hekur betoni, punime bojatisje etj.* Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga ankimuesi në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, KPP vëren, se ankimuesi në përmbushje të kriterit kualifikues lidhur me punimet e meparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 5 (pesë) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ka dorëzuar dokumentacionin e listuar në pikën III.2.2 të këtij vendimi.

Referuar dokumentacionit të sipërpërmendur, Komisioni konstaton, se referuar kontratës së dorëzuar nga ankimuesi në SPE, operatori ekonomik “Mane/S” shpk ka kryer punime si vijon: punime shtresash, punime tavani dhe suvatim, punime hekur betoni, punime bojatisje etj., Komisioni gjykon se, kontrata e paraqitura nga operatori ekonomik ankimues përbën punë të ngjashme, në kuptim të pikës 2.3.1 të Kriterëve të veçanta të kualifikimit. Sipas praktikës së konsoliduar të Komisionit të Prokurimit Publik, ngjashmëria e punëve vlerësohet sipas funksionit teknik dhe objektit. Rezulton se Kontrata Publike me nr. 33 prot., datë 06.03.2025 me objekt “*Investime në infrastrukturën arsimore në kopshte dhe shkolla*”, lidhur midis operatorit ekonomik “Mane/S” SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Sarandë, me vlerë 35,079,035.04 lekë me tvsh, ose 29,232,529 lekë pa tvsh në thelb është e ngjashme me objektin e prokurimit të procedurës objekt ankimi, pasi jemi përballë tipologjive të ngjashme të ndërtimeve sepse si në kontrata e sipërpërmendur, po ashtu edhe kontrata objekt prokurimi kanë si objekt ndërtim civil dhe në të dyja kontratat ka zëra jo vetëm të ngjashëm por edhe të njëjtë me njëri tjetrin, sikurse është përmendur më lart, pra provohet realizimi i punëve të ngjashme sipas natyrës teknike; për rrjedhojë, përmbushet kriteri i veçantë i kualifikimit, pika 2.3.1 të shtojcës nr. 7, të dokumentave të tenderit përsa i përket ngjashmërisë së punëve të kryera. Po ashtu, vlera e kontratës së paraqitur nga ankimuesi prej 29,232,529 lekë pa tvsh është më e madhe se ajo e kërkuar në dokumentat e tenderit. 26,933,897 lekë pa tvsh. Edhe afati i realizimit, data 27.08.2025 është brenda afatit 5 vjeçar të kërkuar në dokumentat e tenderit. Sa më sipër, KPP gjykon, se referuar kriterit të përcaktuar në dokumentet e tenderit, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, për të vërtetuar eksperiencën e mëparshme të ngjashme, është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Kriteret për kualifikim, vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se kontrata dhe fatura e mësipërme të paraqitur nga operatori ekonomik “Mane/S” SHPK plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit në pikën 2.3.1. të kapacitetit teknik, lidhur me ngjashmërinë e punëve të kryera, rrjedhimisht arsyeja e skualifikimit të KVO-së nuk është e drejtë.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e*

rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “RSM COMPANY” SHPK, përfaqësuar nga dega e saj në Shqipëri shoqëria “R|S|M Construction” në procedurën e prokurimit “E hapur,” me REF-81377-04-08-2026, me objekt: “Investime për transformimin e aseteve publike me potencial zhvillimi në modele të standardit më të lartë të zhvillimit: “Përforcimi i godinës së shtëpisë së fëmijës “Vangjel Pulla”, Sarandë.” me fond limit 53,867,793.17 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
 2. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Mane/S” SHPK në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.
 3. Autoriteti kontraktues të kryejë rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik në këtë vendim.
 4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 5. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga nga operatori ekonomik “RSM COMPANY” SHPK, përfaqësuar nga dega e saj në Shqipëri shoqëria “R|S|M Construction”.
 6. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Mane/S” SHPK.
 7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 8. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiovent Zguro

